



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E DEÇANIT
MUNICIPALITY OF DEÇAN
OPSTINA DEÇAN



Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2, shkronja (d), nenit 17 shkronja (s), nenit 40 paragrafi 40.2 shkronja (h) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr. 03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28/2008), si dhe nenit 15 pika 23, nenit 26 pika 19, nenit 28 paragrafi 1 pika 4, të Statutit të Komunës së Deçanit, 01.Nr.IX-5, dt.31.10.2019, me propozimin e Kryetarit të Komunës, z.Bashkim Ramosaj, Kuvendi i Komunës së Deçanit në mbledhjen e jashtëzakonshme të mbajtur me dt.11.06.2024, merr këtë:

V E N D I M

PËR SHPALLJEN "QYTETAR NDERI" I KOMUNËS SË DEÇANIT

Dr. MENTOR PETRELA

1. Miratohet propozimi i Kryetarit të Komunës, Nr.01-17751, dt.06.06.2024 dhe merret vendim për shpalljen "QYTETAR NDERI" i Komunës së Deçanit, Dr.Mentor Petrela, lindur në Tiranë në vitin 1950.
2. I përmenduri sipas pikës 1 të këtij vendimi shpallet "QYTETAR NDERI" për kontributin e tij të jashtëzakonshëm në fushën e shëndetësisë, e në veçanti për ndihmën dhe angazhimin e tij ndaj qytetarëve të Komunës së Deçanit.
3. Me rastin e shpalljes, Kryetari i Komunës së Deçanit, do t'i dorëzojë, Dr.Mentor Petrela titullin "Qytetar Nderi" i Komunës së Deçanit dhe do të regjistrohet në regjistrin e bartësve të titullit "Qytetar Nderi" i Komunës së Deçanit.
4. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës së Deçanit.
5. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen e komunës së Deçanit.

KUVENDI I KOMUNËS SË DEÇANIT

01.Nr.II-1

Deçan, dt.11.06.2024

KK. DEÇANI.AS	18350
01	12.06.24



Kryesuesi i Kuvendit
Hajdar SUTAJ



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E DEÇANIT
MUNICIPALITY OF DEÇAN
OPSTINA DEÇAN



Në bazë të Qarkores Buxhetore 2025/01 të Ministrisë për Financa të dt.15 Maj 2024, në bazë të nenit 40.2 shkronja (b) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", Nr.28/2008), nenit 26 pika 2. të Statutit të Komunës së Deçanit, 01.Nr.IX-5, dt.31.10.2019, Kuvendi i Komunës së Deçanit në mbledhjen e mbajtur me dt.28.06.2024, miraton këtë:

V E N D I M

PËR APROVIMIN E KORNIZËS AFATMESME BUXHETORE (KAB) PËR KOMUNËN E DEÇANIT PËR VITET 2025-2027

I.

Aprovohet Korniza Afatmesme Buxhetore (KAB) për Komunën e Deçanit për vitet 2025-2027.

-Buxheti i planifikuar sipas Qarkores buxhetore 2025/01, për vitin 2025 është – 14,401,936.00€ (13,501,365.00€ nga grantet dhe 900,571.00€ nga të hyrat vetanake)

-Buxheti i planifikuar sipas Qarkores buxhetore 2025/01, për vitin 2026 është – 15,096,316.00€ (14,118,037.00€ nga grantet dhe 978,279.00€ nga të hyrat vetanake)

-Buxheti i planifikuar sipas Qarkores buxhetore 2025/01, për vitin 2027 është – 15,806,773.00€ (14,750,107.00€ nga grantet dhe 1,056,666.00€ nga të hyrat vetanake)

II.

Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është Korniza Afatmesme Buxhetore (KAB) për Komunën e Deçanit për vitet 2025-2027.


III.

Vendimi hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit dhe 15 dit pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen e Komunës.

IV.

Me Vendim njoftohen: MF-Departamenti i Buxhetit, Zyra e Kryetarit, Drejtoritë komunale dhe Arkivi i Komunës.

01.Nr. VI- 2 ,
Deçan,dt.28.06.2024



Kryesuesi i Kuvendit
Hajdar SUTAJ





Në bazë të nenit 12, paragrafi, 12.2 shkronja (c) të Ligjit nr. 03/L – 040, për Vetëqeverisje Lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 28/2008), nenit 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Ligjit Nr.06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, në bazë të nenit 17 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2, të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.04/2023 për administratë të hapur në Komunë , në bazë të nenit 13 paragrafi 1.1, të Rregullores (MAPL) nr.02/2021 për procedurën e hartimit dhe publikimin e akteve të Komunës, në bazë të nenit 26 paragrafi 1 të Statutit të Komunës së Deçanit, 01.Nr.IX-5, dt.31.10.2019 Kuvendi i Komunës së Deçanit në mbledhjen e mbajtur me dt.28.06.2024, merr këtë:

V E N D I M

PËR VËNIEN NË KONSULTIM PUBLIK TË DRAFT – RREGULLORES PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS PËR PERIUHDËN DERI NË NJË VIT

I.

Kuvendi i Komunës së Deçanit merr vendim për vënien në Konsultim Publik të Draft- Rregullores për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës për periudhën deri në një vit, për Komunën e Deçanit.

II.

Diskutimi publik zgjatë 30 ditë, përkatësisht prej datës 05.07.2024 deri me datën 05.08.2024, brenda së cilës Drejtoria për Buxhet dhe Financa në koordinim me Drejtorinë për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor, me Zyrën e Kuvendit dhe Zyrën për Informim mund të organizojnë diskutime/konsultime të ndryshme me palët e interesuara për këtë draft-rregullore, ndërsa Debat i përgjithshëm publik me qytetarë do të mbahet me dt.18.07.2024, duke filluar nga ora 14:00, në Sallën e Konferencave kati i II-të në objektin e Komunës.

III.

Pyetjet, vërejtjet, sugjerimet dhe komentet mund të drejtohen në Drejtorinë për Buxhet dhe Financa, Zyrën e Kuvendit ose në Zyrën për Informim.

IV.


Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Zyra e Kuvendit të Komunës së Deçanit.

V.

Vendimi hyn në fuqi 15(pesëmbëdhjetë) dit pas regjistrimit në zyrën e protokollit të MAPL-së dhe pas publikimit në ueb faqen e Komunës në gjuhët zyrtare.

01.Nr.VI-4

Deçan,dt.28.06.2024



Kryesuesi i Kuvendit
Hajdar SUTAJ



Bazuar në Ligjin Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, neni 34 paragrafi 34.1 dhe Ligji Nr.08/L-260 Mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2024 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Nr. 26 / 29 Dhjetor 2023), në bazë të nenit 12 paragrafi 12.2 shkronja d), neni 40 paragrafi 40.2 shkronja (b) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040 “Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës” nr.28 e datës 04.06.2008, dhe neni 26 pika 2. të Statutit të Komunës së Deçanit, 01.Nr.IX-5, të datës 31.10.2019, në bazë të vlerësimit të ekspertit vlerësues të pasurive të paluajtshme, Kuvendi i Komunës së Deçanit në mbledhjen e mbajtur me dt.28.06.2024, merr këtë:

V E N D I M

PËR KOMPENZIMIN E PRONËS SË SHPRONËSUAR TË FAMILJES GJOCI NGA FSHATI BABALLOQ

- I. Kuvendi i Komunës së Deçanit merr vendim për kompenzimin me mjete financiare në shumën prej 11,165.50 €, të pronës së paluajtshme (tokës) së shpronësuar të familjes Gjoci nga fshati Baballoq, pronë e cila është lëshuar me kompenzim për nevojat e SHFMU “Dëshmorët e Baballoqit”, sipas një Marrëveshje mes pronarit dhe përfaqësuesve të shkollës, është pjesë nga parcela nr.322-0 me sipërfaqe 03 ari 19 m, Z.k. Baballoq.


Pagesa e mjeteve financiare në vlerë prej 11,165.50 €, do të bëhet nga kategoria Mallra dhe Shërbime, nga Zyra e Kryetarit, kodi ekonomik:10/631/16015/130/0111, ose nga Drejtoria për Buxhet dhe Financa kodi ekonomik 10/631/17515/130/0112 ose nga Drejtoria për Shërbime Publike kodi ekonomik 10/631/18015/130/0451.

- II. Kuvendi i Komunës ka marrë vendim për shpalljen e pronës së paluajtshme të familjes Gjoci me interes për Komunën, me Vendimin e Kuvendit 01.Nr.X-7, i datës 30.10.2020, në bazë të cilit zhvillohet edhe procedura e shpronësimit, sipas vlerësimit të ekspertit vlerësues të pasurive të paluajtshme, mirëpo që ende nuk ka mundur të ekzekutohet për shkak të mungesës së mjeteve financiare.
- III. Për ekzekutimin e këtij vendimi do të kujdeset, Drejtoria për Buxhet dhe Financa e Komunës së Deçanit.
- IV. Vendimi hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit dhe 15 dit pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen e Komunës.
- V. Me Vendim njoftohen: MF-Departamenti për Buxhet dhe Financa, Zyra e Kryetarit, Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Drejtoria për Shërbime Publike dhe Arhivi i KK Deçan.

01.Nr.VI-5
Deçan, dt.28.06.2024

KUVENDI I KOMUNËS SË DEÇANIT

Kryesuesi i Kuvendit
Hajdar SUTAJ





Në bazë të Kërkesës së z.Ibrahim Cacaj nga Deçani, të dt.14.06.2024, nr.01-18657, për regjistrimin e rrugës sipas planit rregullues dhe projektit të qendrës së qytetit, sipas dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, shkronja (d) dhe nenit 14 paragrafi 14.1, nenit 17 shkronjat a), b) dhe c), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", Nr.28/2008), Në bazë të Ligjit nr.2003/11 për Rrugë si dhe nenit 15 pikat 1, 2 dhe 3 të Statutit të Komunës së Deçanit, 01.Nr.IX-5, dt.31.10.2019, Kuvendi i Komunës së Deçanit në mbledhjen e mbajtur me dt.28.06.2024, miraton këtë:

V E N D I M

PËR REGJISTRIMIN E RRUGËS SIPAS PLANIT RREGULLUES DHE PROJEKTIT TË QENDRËS SË QYTETIT TË DEÇANIT

I.

Me këtë vendim aprovohet kërkesa e z.Ibrahim Cacaj nga Deçani, për regjistrimin e rrugës sipas planit rregullues dhe projektit të qendrës së qytetit të Deçanit.

II.

Rruga është e asfaltuar dhe në përdorim të qarkullimit të lirë të qytetarëve, rrugë që lidhët me rrugën "Sali Çeku", shtrihet në pronë komunale dhe pronë private, Zona Kadastrale Deçan, rruga është me gjatësi 199.6m, me gjerësi 6.00m, plus trotuare nga 1.5m, që në total është 9.00 m e gjerë, e cila mundëson zhvillimin e zonës në interes të përgjithshëm publik.

Në këto parcela:

Në parcelën nr. 01101-1, sipërfaqja që merret për rrugë 897m²; pronar KOMUNA E DEÇANIT.

Në parcelën nr.04688-0 sipërfaqja që merret për rrugë 181m²; pronar KOMUNA E DEÇANIT.

Në parcelën nr.01073-7 sipërfaqja që merret për rrugë 29m²; pronar KOMUNA E DEÇANIT.

Në parcelën nr.01073-8 sipërfaqja që merret për rrugë 35m² dhe, pronar KOMUNA E DEÇANIT.

Në parcelën nr.01099-0 sipërfaqja që merret për rrugë është 82m², pronar KOMUNA E DEÇANIT.

Në parcelën nr.01081-0 sipërfaqja që merret për rrugë është 8m², pronar KOMUNA E DEÇANIT.

Në parcelën nr.01080-0 sipërfaqja që merret për rrugë është 16m², pronar KOMUNA E DEÇANIT.

Në parcelën nr.01079-0 sipërfaqja që merret për rrugë është 18m², pronar KOMUNA E DEÇANIT.


Në parcelën nr.01078-0 sipërfaqja që merret për rrugë është 2m², pronar KOMUNA E DEÇANIT.

Në parcelën nr.04688-0 sipërfaqja që merret për rrugë është 262m², pronar KOMUNA E DEÇANIT.

Në parcelën nr.01068-0 sipërfaqja që merret për rrugë është 299m², pronar IBRAHIM (ZYMER) CACAJ

III

Për ekzekutimin e këtij vendimi do të kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtorja për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor dhe Drejtorja për Gjeodezi dhe Kadastër të Komunës së Deçanit.



IV.

Vendimi hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit dhe 15 dit pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen e Komunës.

V.

Me Vendim njoftohen: Zyra e Kryetarit, Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor, Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër, Arhivi i Komunës së Deçanit.

01.Nr.VI-7

Deçan,dt.28.06.2024

Kryesuesi i Kuvendit
Hajdar SUTAJ





Ne bazë të nenit 14 dhe nenit 58 pika a), b), d), g) i), të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-40, në bazë të nenit 3 paragrafi 1.4, 1.12 dhe 1.13, nenit 5, 6 paragrafi 1 nen paragrafi 1.2 dhe paragrafi 1 nen paragrafi 1.2, nenit 14, nenit 19 të Ligjit nr.06/L-092 për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës”, Nr.10/03, Prill 2019), në bazë të nenit 13 dhe nenit 22 të Rregullores (QRK) Nr.09/2020 për Përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, si dhe nenit 22 dhe 56 të Statutit të Komunës së Deçanit, 01.Nr.IX-5, dt.31.10.2019, me propozimin e Kryetarit të Komunës, Kuvendi i Komunës së Deçanit në mbledhjen e mbajtur me dt.28.06.2024, merr këtë:

V E N D I M
PËR DHËNIEN E PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS NË SHFRYTËZIM
AFATGJATË

I. MIRATOHET propozimi i Kryetarit të Komunës dhe merret Vendimi për dhënie e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim afatgjatë për 99 vite.

II. Prona e paluajtshme e komunës së Deçanit që jepet në shfrytëzim afatgjatë është në harmoni me dokumentet e planifikimit hapësinorë të Komunës: Parcela kadastrale e identifikuar me certifikatë të pronësisë Nr.00736-0, Njësia kadastrale: P-70505065-00736-0, me sipërfaqe të përgjithshme prej 8466 m² (me kulturë kullosë e klasës 4 sipërfaqja prej 7942 m² dhe Shtëpi- ndërtesë sipërfaqja prej 524 m²), në vendin e quajtur “Arat e Kodrës”, Zona kadastrale Rastavicë, në pronësi të Komunës së Deçanit.

III. Prona e paluajtshme e Komunës i jepet në shfrytëzim afatgjatë z.Arton Kadrijaj, Rastavicë, Deçan.

IV. Qëllimi i dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës së Deçanit është për ndërtimin e projektit investiv “Rregullimi i parterit, Muret Mbrojtëse Plantacioni i Kumbullave” në Rastavicë, Komuna Deçan, që do të ndikoj në zhvillimin ekonomik të Komunës.

V. Afati kohorë për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës, është si në pikën I. të këtij vendimi, për 99 vite.

VI. Prona e paluajtshme e cekur në pikën II. Të Vendimit jepet në shfrytëzim me kompensim.

VII. Mënyra dhe kushtet e shfrytëzimit të pronës së paluajtshme do të përcaktohen me kontratë, e cila lidhet dhe nënshkruhet në mes të Kryetarit të Komunës dhe shfrytëzuesit.

VIII. Prona e paluajtshme komunale që jepet në shfrytëzim e përshkruar në pikën II të këtij vendimi duhet të evidentohet në librat kadastralë të Komunës.

IX. Për zbatimin e këtij Vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtorja për Gjeodezi dhe Kadastër dhe Drejtoritë kompetente të Komunës së Deçanit.

X. Vendimi hyn në fuqi 15(pasëmbëdhjet) dit pas regjistrimit në zyrën e protokollit të MAPL-së dhe pas publikimit në ueb faqen e Komunës në gjuhët zyrtare.

01.Nr.VI-6
Deçan, dt.28.06.2024

K.K. DEÇAN AS 21075
01 05-07-24



Kryesuesi i Kuvendit
Hajdar SUTAJ




Komisioni Vlerësues i Ofertave (i themeluar me Vendimin e Kuvendit të Komunës së Deçani 01.nr.III-10, të datës të datës 28.02.2022, i plotësuar dhe ndryshuar me Vendimin 01 ne.40806 të datës 06.12.2023, duke u bazuar në Ligjin Nr. 06/L-092 Për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës , nr. 10/03 Prill 2019), si dhe në Rregulloren (QRK) Nr.09/2020 Për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr.06/20 i datës 05.08.2020), me qëllim të zbatimit të Vendimit Paraprak të Kuvendit Komunal për dhënien në shfrytëzim afatgjatë (99 vite) të pronave të paluajtshme të Komunës përmes procedurave të shprehjes së interesit (sipas Vendimit 01 nr. 1541 i datës 12.01.2024, si dhe kushteve të përcaktuara në njoftimin publik 01 nr 14330 të datës 8.5.2024, në takimin e mbajtur me datë 27.5.2024 , shpallë këtë:


NJOFTIM PËR PËRZGJEDHJEN E OFRTËS EKONOMIKISHT MË TË FAVORSHME

- 1.Komisioni Komunal për Vlerësimin e Ofertave ka pranuar gjithsejtë dy (2) oferta për marrje në shfrytëzim të parcelës me numër kadastral: **P-70505065-00736-0** me sipërfaqe 8466 m2, e cila gjendet në Zonën Kadastrale Rastavicë, në vendin e quajtur "Arat e Kodres" me kulturë kullosë e klasës së 4-të, në pronësi të Komunës së Deçanit.
2. Pas hapjes së ofertave në prezencën e ofertuesve, komisioni konstaton se të dy ofertat janë të përgjegjshme në bazë të kushteve të kërkuara në shpalljen për shprehje të interesit 01 nr.14330 të datës 8.5.2024.
3. Pas Vlerësimit të ofertave, Komisioni unanimisht vendosi që oferta ekonomikisht më e favorshme për Komunën, të cilën vendosi ta përzgjedhë është oferta **02 nr. 16361** e ofertuesit **Arton Kadrijaj**.

Këshillë Juridike: Pala e pa kënaqur me procesin e vlerësimit të ofertave nga ana e komisionit ka të drejtë ankese në komisionin për ankese të KK Deçan në afatin prej 7 ditë kalendarike pas marrjes së këtij njoftimi.



Kryetari i Komisionit


Faruk Hasanramaj



Për: Kryesuesin e Kuvendit Komunal z. Hajdar Sutaj,

Përmes: z. Bashkim Ramosaj, Kryetar i Komunës së Deçanit,

Nga: Faruk Hasanramaj, Kryetar i Komisionit për Vlerësimin e Ofertave për dhënie në shfrytëzim të Pronës Komunale.


Lënda: Rekomandimi i Komisionit të Vlerësimit.

Deçan: 19.6.2024

Komisioni Vlerësues i Ofertave (i themeluar me Vendimin e Kuvendit të Komunës së Deçani 01.nr.III-10, të datës të datës 28.02.2022, i plotësuar dhe ndryshuar me Vendimin 01 ne.40806 të datës 06.12.2023, duke u bazuar në nenet 17, 19 dhe 20 të Ligjit Nr. 06/L-092 Për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 10/03 Prill 2019), neneve 19, 20 dhe 21 të Rregullores (QRK) Nr.09/2020 Për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr.06/20 i datës 05.08.2020), Vendimit Paraprak të Kuvendit Komunal për dhënien në shfrytëzim afatgjatë (99 vite) të pronave të paluajtshme të Komunës përmes procedurave të shprehjes së interesit (sipas Vendimit 01 nr. 1541 i datës 12.01.2024, pas hapjes dhe vlerësimit të ofertave të pranuar pas Njoftimit publik për shprehje të Interesit **Për dhënien në shfrytëzim afatgjatë (99 vite) pronën e paluajtshme të komunës**, Parcelën me numër kadastral: **P-70505065-00736-0** me sipërfaqe 8466 m2 e cila gjendet në Zonën Kadastrale Rastavicë në vendin e quajtur "Arat e Kodrës" me kulturë kullosë e klasës së 4-të, në pronësi të Komunës së Deçanit, me datë 27.5.2024 vendosi të bëjë:

REKOMANDIM

1. I rekomandohet Kuvendit Komunal të Deçanit që të marr vendim për dhënie në shfrytëzim afatgjatë (99 vite) për ofertën 02 Nr. 16361 të datës 27.05.2024, ofertuar nga Arton Kadrijaj, person fizik nga fshati Rastavicë, e cila pas vlerësimit të komisionit për vlerësim për zgjidhet si **oferta ekonomikisht më e favorshme**.



Kryetari i Komisioni

Faruk Hasanramaj



REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA E DEÇANIT

REPUBLIC OF KOSOVO MUNICIPALITY OF DEÇAN
REPUBLIKA KOSOVA OPSTINA DEÇAN



PROCESVERBAL

Komisioni Vlerësues për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës së Deçanit, është themeluar në bazë të vendimit të Kuvendit Komunal në mbledhjen e mbajtur me, dt. 28.02.2022. Asambleja komunale me dt. 28.0.2024 mori në vendim te ri për plotësim ndryshime këtij komisioni pas aprovimit të dorëheqjes se Z. Ismet Kukleci, anëtare e re e këtij komisioni ne propozimin e Kryetarit të Komunës emërohet Lirije Zukaj. Komisioni në fjalë bazuar në vendimin paraprak po shqyrton mundësin e dhëni në shfrytëzim afatgjatë të Parcelës nr.P-70505065-00736-0 me sipërfaqe të përgjithshme 8466 m² me kulturë Kullos e klasës 4, Zona kadastral Deçan, në vendin “Arat e kodrës” – Rastavicë. (sipas Ligjit NR.06/L-092 Për dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 Për Përcaktimin e Proceduarave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronë së Paluajtshme të Komunës dhe Statutit Komunal dhe Ligji mbi Vetëqeverisjen Lokale).

Komisioni vlerësues mbajti Takimin e radhës me, 27.05.2024. Takimi u mbajt në sallën e Asamblesë Komunal - Deçan.

Rendi i ditës:

1. Hapja dhe vlerësimi i Ofertave nga Komisioni Vlerësues, të Njoftimit Publik për Shpallje të Intersit, Për dhënie në Shfrytëzim afatgjatë (99 vite) pronën e paluajtshme të komunës

2. Të ndryshme

Komisioni në përbërje: Kryesuesi i Komisionit Vlerësues z. Faruk Hasanmetaj, Afrim Demhasaj, Halil Tolaj, Sanije Thaqi dhe Lirije Zukaj (Anëtarë/re të Komisionit Vlerësues), mungoi në takim Lirije Zukaj Dabiqaj, e cila është jashtë vendit (Gjermani).

Kryesuesi pasi që e hapi takimin dhe tregoi afatet ligjore qe ishin të shpallura në Njoftimin Publik dhe tha siç jeni ne dijeni sot, dt. 27.05.2024., duhej të bëhej hapja e ofertave, vlerësimi dhe shpallja e ofertuesit që e ka ofertën më të volitshme dhe ja po e realizojmë detyrën tonë. Po paraprakisht dua t'ju pyes ju si anëtar të Komisionit Vlerësues, nëse ka konflikt të mundshëm të interesit për vazhdim të punimeve të Komisionit. Të gjithë u deklaruan se asnjë konflikt interesi nuk ka nga anëtarët e Komisionit Vlerësues.

Kryetari i Komisionit Vlerësuese Z. Faruk Hasanramaj dhe Z. Afrim Demhasaj (Anëtar i Komisionit) i sollën dy ofertat e paraqitura në Zyrën e ofertave dhe poashtu Komisioni Vlerësoj se janë vetëm dy oferta dhe se ofertat ishin në gjendje të rregullt. Prezent gjatë punës së Komisionit Vlerësues ishin edhe dy ofertuesit: Zeqë Muslijaj nga fshati Molliq, Komuna e Gjakovës dhe Artan Kadrijaj nga fshati Rastavic, Komuna e Deçanit, që njëkohësisht të vetmit ofertues në njoftimin e shpallur me dt. 08.05.2024.

Me propozimin Kryesuesit të Komisionit Vlerësues u vendos që në prezencë të ofertuesve të bëhet hapja e ofertave të dorëzuara në pliko (zarfe) të mbyllura dhe brenda afatit kohor bazuar në Njoftimin Publik. Po ashtu është konstatuar nga Komisioni Vlerësues se Ofertat janë të protokolluara. Oferta e parë Zeqë Muslijaj me Nr. Protokoli 02 nr.16360 të dt. 27.05.204 dhe oferta e dytë Arton Kadrijaj me Nr. Protokoli 02 .nr.16361 , dt.27.05.2024.

Komisioni Vlerësues konstatoi se publikimi i Njoftimit publik për Shpallje të Interesit është bërë konformë Ligjit NR.06/L-092 Për dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, në Web faqen zyrtare të Komunës dhe në tabelën e shpalljeve komunale.

Kryesuesi z. Faruk Hasanramaj e hapi të parën ofertë të ofertuesit Zeqë Muslijaj dhe të dytën të ofertuesit Arton Kadrijaj, pasi që edhe një herë konstatuan që ofertat ishin të mbyllura mirë.

Ofertuesi Zeqë Muslijaj formularit të aplikimit ja ka bashkangjitur:

- Planin e biznesit
- Projektin ideor
- Paramanën dhe paralogaritë
- Hurdha e peshqve
- Dokumentin e identifikimit
- Certifikatën mbi dëmet penale
- Vërtetimin e tatim në pronë dhe
- Një çmim prej 205 Euro për ari me vlerë investive prej 50.600 Euro dhe me një numër të punësuarve aktualisht dy (2) dhe pas investimeve deri në pesë (5) të punësuar.

Ofertuesi Arton Kadrijaj formularit të aplikimit ja ka bashkangjitur:

- Planin e biznesit
- Projektin investiv
- Dokumentin e identifikimit
- Certifikatën mbi dëmet penale
- Vërtetimin mbi obligimet ndaj tatimit në pronë
- Si dhe një çmimi prej 255 euro për ari me një vlerë investive 187.312 Euro me një mundësi punësimi prej tre (3) deri në dhjetë (10) punëtorë.

Në pyetjen e Kryetarit të Komisionit vlerësues rreth vërejtjeve të eventuale të ofertuesve të pranishëm me rastin e hapjes së ofertave të njëjtit deklarojnë se nuk kanë asnjë vërejtje dhe dy ofertuesit braktisën sallën e takimit.

Komisioni vlerësues pas hapjes së ofertave konstaton se ka numër të mjaftueshëm të ofertave për të proceduar më tutje pas një rishikimi të dytë detal të dokumenteve që ishin në pliko. Komisioni i8 unanimisht erdhi në përfundim që Kuvendit Komunal t'i rekomandohet dhënia në Shfrytëzim afatgjatë (99 vite) prona e paluajtshme e komunës, Parcela nr.P-70505065-00736-0 me sipërfaqe të përgjithshme 8466 m² me kulturë Kullo e klasës 4, Zona kadastral Deçan, në vendin "Arat e kodrës" – Rastavic, Ofertuesit Arton Kadrijaj nga Rastavica, i cili ka ofruar ofertën me vlerë investive dhe projektin investiv ekonomikisht më të favorshëm.

Komisioni i Vlerësues po ashtu konstaton se ofertuesi i përzgjedhur Arton Kadrijaj obligohet që obligimet komunale dhe shumën e pagesës duhet t'i realizoj në afat kohor brenda 30 ditësh, pas miratimit nga Kuvendi Komuna.

2. Në pikën të ndryshme Komisioni i vlerësues diskutoi për përgatitjen e Procesverbalit, Raportin dhe nënshkrimet e të gjithë anëtarëve të Komisionit Vlerësues dhe Kryetarit të Komisionit në Procesverbal dhe dy ofertuesve dhe dorëzimi i këtyre dokumenteve në Zyrën e administratës së Kuvendit Komunal nga Kryetari i Komisionit Vlerësues z. Faruk Hasanramaj për procedim të mëtejshëm.

Përbërja e Komisionit Vlerësues

Emri	Mbimri	Pozita	Nënshkrimi
Faruk	Hasanramaj	(Kryetari komisionit)	
Afrim	Demhasaj	(Anëtar i komisionit)	
Halil	Tolaj	(Anëtarë i komisionit)	
Lirije	Zukaj	(Anëtare e komisionit)	
Saniye	Thaqi	(Anëtare e komisionit)	

Ofertuesit

Emri	Mbimri	Ofertuesit	Nënshkrimi
Zeqë	Muslijaj	ofertues	
Arton	Kadrijaj	ofertues	

Kryetari i Komisionit Vlerësues:

Faruk Hasanramaj

Deçan:

27.05.2024



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës / Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture /
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-70505065-00736-0

Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number:	20981
Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission:	05.07.2024 - 11:44
Komuna / Opština / Municipality:	DEÇAN / DEČANE / DEÇAN
Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone:	Rastavicë / Rastavica / Rastavicë
Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office:	DEÇAN / DEČANE / DEÇAN

A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

Numri i njësisë kadastrale Broj katastarske jedinice Cad. Unit. No.	Lloji i njësisë Vrsta Jedinice Unit Type	Lloji i pronës Vrsta imovine Property Type	Zona U/R G/S U/R	Sipërfaqja Površina Area (m ²)	Përshkrim Opis Description	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
P-70505065-00736-0	PARCELË / PARCELA / PARCEL	Pronë shoqërore / Drushtvena Imovina / Socially owned Land	Rural	8466			

A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKJE JEDINICE / CADASTRAL UNIT ADDRESS

Vendi i quajtur Mesto zvano Called place	Kodi Postal Poštanski Kod Postal Code	Emri i rrugës Naziv ulice Street name	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
ARAT E KODRES				



A.2 LLOJI I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE

Numri Broj Number	Lloji i shfrytëzimit të parcelës Vrsta koriscenja parcele Parcel Type Of Use	Shfrytëzimi aktual i parcelës Trenutno koriscenje parcele Parcel Current Use	Kualiteti i klasës Kvalitet klase Quality Class	Sipërfaqja (m²) Površina (m²) Area (m²)
1	Bujqësore/Poljoprivredno/Agriculture	Kullosat/Paşnjaci/pasture	Kullosë E Klasës 4/Paşnjak 4 Klase/4th Class Pasture	7942
2	Tokë Ndërtimore/Gradjevinsko zemljište/Construction land	Shtëpi-Ndërtese/Kuca-Zgrada/House-Building		524

B. PRONARI/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

Të drejtat Prava Rights	Emri Ime Name	Nr. personal Licni broj ID. No.	Vendbanimi Prebivaliste Resident	Kodi postal Poštanski kod Postal code	Hollësitë e adresës Pojedinsti adrese Address details	Pjesa e pronës Deo imovine Share quota	Pershkrimi Opis Description	Azhuruar Ažurirano Updated
Posedim individual / Individualna Drzavina / Single possessor	Komuna e Deçanit	600325668	///		JASHAR SALIHU	1/1		



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE
MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : DEÇAN

Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Rastavicë

Njësia/Jedinica/Unit	Tipi/Vrsta/Type	Sipërfaqja/Povšina/Area m ²
P-70505065-00736-0	Parcelë / Parcela / Parcel	8466



Shkalla/Razmera/Scale: 1:1042

Punoi/Obradio/Created: Jetmir Avdiu

Nënshkrimi/Potpis/Signature: _____

Shënim/Beleška/Note: _____



Data/ Data/Date: 05.07.2024

Koha/ Vreme/ Time: 11:48:18